



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 82 /2024  
Datë: 30 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 3 të Rregullores Nr.01/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.09/2015 për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Këshillit Prokurorial, në takimin e mbajtur më datë 30 janar 2024, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Znj. Jehona Grantolli, anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, zgjedhet Zëvendës Kryesuese e Këshillit Prokurorial të Kosovës, me mandat dy (2) vjeçar, e zgjedhja në këtë funksion nuk e zgjat mandatin e anëtarit të Këshillit.
- II. Znj. Jehona Grantolli, do të pezullojë pozitën e prokurores në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës së ushtrimit të pozitës të Zëvendës Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- III. Znj. Jehona Grantolli do të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e saj në bazë të legjislacionit në fuqi.
- IV. Znj. Jehona Grantolli ka të drejtë në shfrytëzimin e beneficioneve që rrjedhin nga ushtrimi i pozitës të Zëvendës Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- V. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

  
Jetish Maloku  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- znj. Jehona Grantolli;
- Kryeprokurorit të PTH Prishtinë;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- NJSHP;
- Arkivit të KPK-së.